



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisioni Vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE
PRISHTINE

Pranuar me:	20.06.2022		
N. org.	Numer	Sasia	Vlera
01	3295	4	-

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

Fakulteti

Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore

Lëndët

Grup lëndësh nga Kimia Analitike (pozita 14 FSHMN)

Kandidatët e paraqitur

1. Arbër Musliu
2. Arbër Frangu

Komisioni Vlerësues

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. Dr. Fatbardh Gashi

Prof. Assoc. Dr. Ramiz Hoti

Prof. Dr. Ramë Vataj



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Vlerësim dhe propozimi:

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të materialit të paraqitur nga kandidatët, komisioni vlerësues i emëruar me vendimin e Këshillit të FSHMN-së nr. 3030, të datës 08. 06. 2022, vlerëson dhe propozon:

Në konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr 1/217, dt. 01. 06. 2022 (FSHMN pozita 14) janë paraqitur dy (2) kandidatë si në vijim:

1. **Msc. Arbër Musliu**, i lindur më 20. 12. 1995 në Ferizaj, studimet Bsc në drejtimin Kimi i ka përfunduar në vitin 2017 në Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 8.59, ndërsa në vitin 2020 ka përfunduar studimet e masterit në Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 9.00 dhe ka marrë gradën Master i shkencave të kimisë, programi Kimi analitike dhe mjedisore. Në vitin 2020 kandidati ka regjistruar studimet e doktoratës në Universitetin e Prishtinës. Kandidati ka të publikuar një (1) punim si koutor dhe ka marrë pjesë në dy (2) konferenca shkencore. Në bazë të Rregullores 1/95, dt. 24. 06. 2021, neni 7 (alineja 3.1-4), kandidati Msc. Arbër Musliu i plotëson të gjitha kriteret për angazhim sipas konkursit për pozitën 14, FSHMN, UP.

2. **Msc. Arbër Frangu**, i lindur më 03. 09. 1991 në Slatinë e poshtme, Komuna e Vitisë, studimet Bsc në drejtimin Kimi i ka përfunduar në vitin 2013 në Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 8.88, ndërsa në vitin 2015 ka përfunduar studimet e masterit në Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 9.24 dhe ka marrë gradën Master i shkencave të kimisë, programi Kimi analitike dhe mjedisore. Në vitin 2016 kandidati ka regjistruar studimet e doktoratës në Universitetin e Prishtinës. Kandidati ka të publikuar katër (4) punime si autor i parë ose koautor. Në bazë të Rregullores 1/95, dt. 24. 06. 2021, neni 3 (alineja 3.3), kandidati Msc. Arbër Frangu nuk i plotëson kriteret për angazhim sipas konkursit për pozitën 14 FSHMN, meqenëse e ka kaluar kriterin e moshës.

Duke u bazuar në dispozitat e Statut të Universitetit të Prishtinës (neni 178, alineja 1.1-4), dhe të rregullores Nr.1/95, datës 24. 06. 2021 (neni 7, alineja 3.1-4), komisioni i propozon Këshillit të FSHMN-së dhe Senatit të Universitetit të Prishtinës Hasan Prishtina, që kandidatin **Ass. Msc. Arbër Musliu** t'a angazhojë si bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve për grup lëndësh nga Kimia analitike.

Prishtinë,

20. 06. 2022

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI SHKENCAVE MATEMATIKO-NATYRORE
PRISHTINË

Planuar me:	20. 06. 2022		
Ni. org:	Numbër	Sasia	Vlera
01	3285	4	—

Komisioni vlerësues:

1. Prof. Dr. Fatbardh Gashi
2. Pof Assoc. Dr. Ramiz Hoti
3. Prof Dr. Ramë Vataj